





# EKONOMIA DHE BUXHETI

2014



# Raporti Mujor

Qershor, 2014

Kontakt:

e-mail: [marsed.harizi@financa.gov.al](mailto:marsed.harizi@financa.gov.al)

e-mail: [ernil.sabaj@financa.gov.al](mailto:ernil.sabaj@financa.gov.al)

(website - [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al))

## PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE.....	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL.....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR.....	13


## VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin qershor 2014 arriti në 116.51 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin qershor ishte 1.5 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin qershor 2014 ishte 103.09 lekë për dollarë dhe 140.13 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit qershor shënuan kuotat 1.76 për ato 12-mujore, 1.33 për 6-mujoret dhe 0.97 për qind për depozitat 3-mujore dhe 2.06 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.20 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.40 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,152,6 miliardë lekë në muajin qershor, duke shënuar një rritje prej rreth 1.0 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për periudhën T1 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 37.2 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-qershor 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 22.2 miliardë lekë, ose 60.8 për qind më pak e planit për këtë muaj ( e cila ishte 56.7 miliardë).
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës janar - qershor 2014, arritën në rreth 175.206 miliardë lekë, ose 102.6 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 197.401 miliardë lekë, ose 86.8 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë muaj.

## ZHVILLIMET EKONOMIKE

### 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin qershor 2014 shënoi një rënie prej 0.7 për qind krahasuar me muajin maj '14, kur ky indeks shënonte një rënie prej 1.1 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit prill '14, ky indeks ishte 0.6 për qind më i lartë se në muajin mars '14. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti



**Ndryshimet mujore të IÇK-së**

Burimi: INSTAT

më parë ishin 1.5 për qind, 1.6 për qind dhe 1.7 për qind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit maj u konstatua në grupin "Shëndeti" me 6.34 për qind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit (rreth 0.2 pikë përqindjeje). Ndërsa rritja

më e madhe u konstatua në grupin "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 8.19 për qind (duke kontribuar me 0.4 pikë përqindje në normën e inflacionit).

Norma vjetore e inflacionit në muajin qershor arriti në 1.5 për qind, duke qendruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2013 dhe 2014 paraqiten në tabelën 1.


**Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)**

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2013</b>	2.7	2.5	2.4	2.3	2.1	2.3
<b>2014</b>	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	<b>1.5</b>
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2013</b>	1.6	1.2	1.7	1.7	1.0	1.9
<b>2014</b>						

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin qershor 2014, arriti në 140.13 lekë/euro, duke shënuar një rënie me 0.1 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit qershor, një euro u këmbye me 140.26 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin qershor 2014, arriti në 103.09 lekë/dollarë



**Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit qer'14**

Burimi: Banka e Shqipërisë


duke shënuar një rritje prej 1.2 për qind kundrejt muajit maj '14. Në fund të muajit qershor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 102.78 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin qershor të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 3.6 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është mbiçmuar me 0.5 për

qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 0.736 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrja nga Banka e Shqipërisë, etj.


### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit qershor 2014, normat e interesit të depozitave 12 mujore në lekë arritën kuotën e 1.76 për qind, duke shënuar një rënie me 0.18 pikë përqindje krahasuar me



muajin maj 2014. Rënie për këtë muaj ka patur edhe në normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 1, 3 dhe 6 - mujore respektivisht me 0.6, 0.10 dhe 0.29 pikë përqindje, duke shkuar përkatësisht në 2.06, 0.97 dhe në 1.33 për qind. Rritje për këtë muaj nuk ka patur në asnjë prej normave të interesit të depozitave. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë,

kanë pësuar rënie normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.




Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit qershor pësoi një rënie me 1.3 pikë përqindje, duke arritur në 8.20 për qind nga 9.50 për qind që ishte në muajin maj 2014. Për këtë muaj, norma e interesit të huave 6-mujore shënuar një rritje me 0.79 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin maj arriti në 9.40 për qind. Krahasuar me të njëjtën

periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të huave me afate maturimi 6 dhe 12-mujore.


Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit qershor 2014, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.26, 3.14 dhe 3.02 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në *yield*-et e bonove të thesarit për të gjitha afatet e maturimit 12-mujore, 6-mujore dhe ato 3-mujore, me respektivisht 0.14, 0.13 dhe 0.03 pikë përqindje.

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për periudhën janar–mars 2014 regjistroi një deficit të përgjithshëm prej 37.2 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5, ku




kontributin më të madh në të e jep zëri i “Llogaria korrente” së bashku me nënzërat e saj, me -299.5 milionë euro, duke u ulur me 30.2% krahasuar me 3-mujorin e parë të vitit 2013. “Llogaria kapitale dhe financiare” për 12-mujorin e vitit 2013-të rezultoi të jetë -253.5 milionë euro, ose gati 8.1% më e lartë se në 3-mujorin e parë të vitit 2013.



Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej -299.5 milionë euro, i shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar – mars '14 rezultoi: (i) bilanci tregtar -356.2 mln euro, (ii) shërbime neto -52.4 mln euro, (iii) të ardhura neto -31.3 mln euro, (iv) transferta neto 140.3 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit qershor 2014, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 35,001.7 milionë lekë krahasuar me qershorin e vitit 2013. Kjo rritje ka



ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në bankat e nivelit të dytë me rreth 37,652.7 milionë lekë. Në zvogëlimin e këtij efekti rritës ndikoi nga ana tjetër dhe rënia e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, me rreth 2,651.0 milionë lekë.

**Ecuria e M.V.N. të sistemit në qer'13 - qer'14**

Burimi: Banka e Shqipërisë



**Agregati M3 qer'13 - qer'14**

Burimi: Banka e Shqipërisë


tepër rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

Në muajin qershor '14 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 9,704.1 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin maj '14, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 5,450.9 milionë lekë dhe e rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 4,253.2 milionë lekë duke e ndihmuar edhe më

## 6. Kredia për Ekonominë


Teprica e kredisë për ekonominë për muajin qershor 2014 arriti në 548.4 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2013 shënoi kthesë gjatë muajit qershor duke u rritur me vlerën e 0.4 miliardë lekë, me një rritje të lehtë prej rreth 0.1 për qind.

Fig-9



**Rritja e stokut total të kredive**  
Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10



**Përberja e kredive qer '14**  
Burimi: Banka e Shqipërisë


lekë, me rreth 56.0 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.2 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 8.95 për qind. “Korporata të tjera jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.48 për qind dhe rreth 23.49 për qind.

Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 59.1 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 323.9 miliardë lekë. Gjatë muajit qershor 2014, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.3 për qind ose 363.7 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.5 për qind ose 150.6 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.51 dhe 1.60 për qind apo 24.8 dhe 8.8 miliardë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin qershor'14, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në

## 7. Oferta e Parasë


Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin qershor ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës maj 2014. Kjo ofertë arriti në rreth 1,152.6 miliardë lekë në fund të



**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

muajit qershor'14 duke shënuar një rritje prej 9.1 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin maj '14. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 1.0 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i dy viteve më përpara. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës maj'14, oferta e parasë pësoi një rritje të lehtë prej 0.8 për qind.



**Raporti i Depozitave ndaj M3**


Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 3.9 miliardë lekë në krahasim me muajin qershor 2013. Depozitat në valutë gjatë muajit qershor '14 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 86.0 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 88.2 për qind të tyre.

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit qershor 2014, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 88.2 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.2 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.8

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 86.0 për qind dhe rreth 11.1 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 87.1 për qind e totalit (në lekë).

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 832.1 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 955.1 miliardë lekë në muajin qershor 2014. Ata

Fig-14



**Përberja e depozitave qer '14**

Burimi: Banka e Shqipërisë

ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (96.8 miliardë), “Korporata jofinanciare publike” (16.4 miliardë) dhe “korporata të tjera financiare” (8.0 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.8 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit maj 2014, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave pësoi një rritje prej 6.1 miliardë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në valutë me rreth 4.3 miliardë lekë si dhe e rritjes së depozitave në lekë me rreth 1.8 miliardë lekë.

## SEKTORI FISKAL

### 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - qershor 2014 janë mbledhur rreth 175.206 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 197.401 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 158.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 19.8 milionë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 35.9% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 102.6% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 86.8% të këtij plani. Shpenzimet korrente

janë rreth 94.6 % e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 74.1 % të tij.


Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 120.3 miliardë lekë (ose rreth 100 % e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 6.2 miliardë lekë (ose rreth 131.3 % e planit të periudhës). Kontributet e

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 30.9 miliardë lekë (ose rreth 99.8 % e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 12.4 miliardë lekë (ose rreth 120.7 % e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 158.8 miliardë lekë, 34.9 miliardë lekë (22% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 20.6 miliardë lekë (13 %) për interesat, 11.4 miliardë lekë (7.2 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 579 milionë lekë (0.4%) për subvencione, 66.7 miliardë lekë (42.1 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 12.1 miliardë lekë (7.6 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 12.1 miliardë lekë (7.6 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 47.2 % (shpenzime personeli), 44.5 % (shpenzime për interesat), 32.4 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 36.2% (subvencione), 49% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 36.6 % dhe 52.8 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 24.8 %, ndërsa financimi i huaj është 32.9 % e planifikimit të tyre vjetor.

Fig - 15



**Treguesit Fiskal, janar - qershor 2014**

Burimi: Ministria e Financave

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - qershor 2014 ishin rreth 175.2 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 157.5 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 12.4 miliardë lekë.

**Tab - 2** Të ardhurat gjatë janar - qershor 2014 (në mld Lekë)

Burimi	qer '14	qer'13	Ndryshimi në (%)
TVSH	61.2	50.7	20.7
Tatimi mbi fitimin	11.2	8.5	31.8
Taksa doganore	2.8	2.6	7.7
Taksat nacionale	15.8	13.1	20.6
Akcizat	16.3	16.2	0.6
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	13.2	14.1	-6.4

Burimi: Ministria e Financave: Statistika Fiskale Mujore: janar - qershor 2014.

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 22.2 miliardë lekë, për periudhën janar - qershor 2014, u mbështet në vlerën 16.5 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 5.7 miliardë nga burime të jashtme. Huamarrja e brendshme ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 96.6% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afat-gjata (rreth 37.8 % të totalit të deficitit).

Për muajin qershor 2014, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 30.589 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 40.842 miliardë lekë,

Në realizimin e të ardhurave për muajin qershor 2014, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 27.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.9 miliardë lekë.

## Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
Janar	0.4	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	0.40	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	2.1	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	January
Shkurt	0.7	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	0.55	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	February
Mars	0.6	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.57	0.71	1.00	0.80	0.77	0.90	1.6	4.1	4.3	1.0	2.4	2.2	March
Prill	-0.1	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	0.40	0.42	0.60	0.58	0.55	0.53	1.9	3.7	4.1	1.6	2.3	1.7	April
Maj	-0.8	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	0.16	0.10	0.26	0.32	0.24	0.20	2.1	3.3	4.2	1.9	2.1	1.6	May
<b>Qershor</b>	-0.6	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	<b>-0.7</b>	0.03	-0.04	0.04	0.12	0.15	<b>0.05</b>	2.3	3.2	3.9	2.2	2.3	<b>1.5</b>	<b>June</b>
Korrik	-0.7	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8		-0.07	-0.10	-0.07	0.08	-0.03		2.2	3.4	3.6	2.7	1.6		July
Gusht	0.7	0.8	0.3	0.4	-0.1		0.03	0.01	-0.02	0.12	-0.04		2.2	3.5	3.1	2.8	1.2		August
Shtator	0.8	0.7	0.4	0.2	0.8		0.11	0.09	0.02	0.13	0.06		2.0	3.4	2.8	2.6	1.7		September
Tetor	0.4	0.2	0.4	0.2	0.1		0.14	0.10	0.06	0.14	0.05		2.3	3.0	3.0	2.4	1.7		October
Nëntor	0.4	0.2	0.1	0.2	-0.5		0.16	0.11	0.06	0.14	0.01		2.8	2.8	2.9	2.5	1.0		November
Dhjetor	1.6	2.2	1.0	0.9	1.7		0.28	0.28	0.14	0.20	0.15		3.7	3.4	1.7	2.4	1.9		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Monedha	2009	2010	2011	2012	2013	2014						Currency
						Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	
<i>Mesatarja e periudhës</i>												
USD	94.98	103.94	100.90	108.18	105.67	103.24	102.75	101.55	101.35	101.89	103.09	USD
EURO	132.06	137.79	140.33	139.04	140.27	140.54	140.32	140.29	140.01	139.99	140.13	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>												
USD	95.81	104.00	107.54	105.85	101.86	103.66	101.58	101.89	101.36	102.72	102.78	USD
EURO	137.96	138.77	138.93	139.59	140.20	140.44	140.14	140.27	140.08	139.86	140.26	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014						
Në përqindje						Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	In percent
<b>Norma e depozitave</b>												<b>Deposits rates</b>
12-M	6.78	6.07	5.87	5.38	4.17	2.39	2.46	2.16	2.21	1.94	1.76	12-M
6-M	5.74	5.16	4.87	4.50	3.40	1.87	1.87	1.66	1.80	1.62	1.33	6-M
3-M	5.05	4.42	4.22	3.83	2.72	1.31	1.53	1.12	1.22	1.07	0.97	3-M
1-M	4.56	4.70	4.39	3.62	2.79	2.43	2.51	2.25	2.21	2.12	2.06	1-M
<b>Norma e huasë</b>												<b>Lending rates</b>
12-M	12.46	11.52	11.17	10.28	9.52	8.67	8.49	6.47	8.60	9.50	8.20	12-M
6-M	12.54	11.69	12.28	10.61	9.59	9.36	8.77	9.34	8.00	8.61	9.40	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>												<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/												Treasury bills 1/
3-M	6.30	5.29	5.31	5.03	3.40	3.36	3.24	3.14	-	3.05	3.02	3-M
6-M	7.52	6.41	6.23	5.65	3.54	3.71	3.52	3.40	3.32	3.27	3.14	6-M
12-M	9.14	7.09	6.95	6.37	3.66	3.82	3.79	3.66	3.56	3.40	3.26	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2014

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>27,774</b>	<b>53,273</b>	<b>82,107</b>	<b>116,161</b>	<b>144,587</b>	<b>175,206</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>824</b>	<b>1,658</b>	<b>2,991</b>	<b>3,507</b>	<b>4,053</b>	<b>5,345</b>	<b>Grants</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>24,326</b>	<b>47,226</b>	<b>73,627</b>	<b>103,682</b>	<b>129,906</b>	<b>157,502</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>17,534</b>	<b>35,349</b>	<b>56,298</b>	<b>77,924</b>	<b>98,335</b>	<b>120,395</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	9,472	19,155	28,677	40,626	50,331	61,177	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,007	2,363	6,332	7,950	9,477	11,167	Profit Tax
3	Akcizat	1,616	3,660	6,110	9,083	12,500	16,274	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	2,569	4,576	6,444	8,716	10,903	13,160	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,482	4,806	7,494	9,842	12,869	15,802	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	388	789	1,241	1,707	2,255	2,755	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>796</b>	<b>1,340</b>	<b>2,162</b>	<b>4,482</b>	<b>5,448</b>	<b>6,235</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	154	340	663	1,691	1,931	2,211	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	304	329	350	379	612	685	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	338	671	1,149	2,392	2,905	3,339	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>5,996</b>	<b>10,537</b>	<b>15,167</b>	<b>21,296</b>	<b>26,123</b>	<b>30,932</b>	<b>Social ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	5,257	9,209	12,860	18,429	22,562	26,776	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndësor	735	1,319	2,283	2,831	3,522	4,105	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	4	9	24	36	39	51	Revenues for property compensation
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,824</b>	<b>4,389</b>	<b>5,489</b>	<b>8,972</b>	<b>10,628</b>	<b>12,359</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	165	320	430	1,871	1,951	1,951	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,810	2,630	3,254	4,818	5,654	6,575	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	498	498	498	498	504	765	Divident
4	Tarifat shërbimeve	139	404	612	842	1,363	1,602	Tariffs on services
5	Të tjera	212	537	695	943	1,156	1,466	Other/not allocated
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>24,963</b>	<b>54,269</b>	<b>88,415</b>	<b>122,526</b>	<b>156,331</b>	<b>197,401</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>24,285</b>	<b>51,451</b>	<b>77,884</b>	<b>103,308</b>	<b>131,222</b>	<b>158,492</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>5,645</b>	<b>11,394</b>	<b>17,268</b>	<b>23,174</b>	<b>29,083</b>	<b>34,938</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	4,856	9,811	14,864	19,954	25,031	30,068	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	789	1,583	2,404	3,220	4,052	4,870	Social insurance contributions
I.2	<b>Interesat</b>	<b>3,819</b>	<b>7,843</b>	<b>10,675</b>	<b>13,039</b>	<b>17,255</b>	<b>20,627</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	3,476	7,058	9,502	11,290	15,144	18,075	Domestic
2	Të Huaja	343	785	1,173	1,749	2,111	2,552	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>1,275</b>	<b>3,225</b>	<b>6,425</b>	<b>8,256</b>	<b>9,670</b>	<b>11,418</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveconet</b>	<b>58</b>	<b>112</b>	<b>265</b>	<b>310</b>	<b>422</b>	<b>579</b>	<b>Subsidies</b>
I.6	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>9,440</b>	<b>20,875</b>	<b>31,372</b>	<b>42,422</b>	<b>54,379</b>	<b>66,726</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	7,432	15,127	23,165	31,405	39,633	48,179	Social insurance
2	Sigurime Shëndësore	2,008	4,754	7,213	10,023	13,752	17,253	Health insurance
3	Fondi i kompensimit te pronareve		994	994	994	994	1,294	Expenditures for Owners Compensation
I.7	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>1,214</b>	<b>3,120</b>	<b>5,041</b>	<b>7,535</b>	<b>9,927</b>	<b>12,121</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.8	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>2,834</b>	<b>4,882</b>	<b>6,838</b>	<b>8,572</b>	<b>10,486</b>	<b>12,083</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	112	198	294	387	454	522	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	2,721	4,684	6,544	8,170	9,970	11,427	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përdjekurve politike	300	300		15	62	134	Compensation for ex-political prisoners
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>678</b>	<b>2,818</b>	<b>10,531</b>	<b>11,466</b>	<b>13,734</b>	<b>19,817</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm	641	1,309	4,025	4,025	4,615	7,109	Domestically financing
2	Financimi Huaj	678	2,177	9,222	7,441	9,119	12,708	Foreign financed
	<b>DEFICITI</b>	<b>2,811</b>	<b>-996</b>	<b>-6,308</b>	<b>-6,365</b>	<b>-11,744</b>	<b>-22,195</b>	<b>CASH BALANCE</b>
	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,811</b>	<b>996</b>	<b>6,308</b>	<b>6,365</b>	<b>11,744</b>	<b>22,195</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
	<b>Brendshëm</b>	<b>-2,179</b>	<b>1,745</b>	<b>1,959</b>	<b>5,673</b>	<b>10,493</b>	<b>16,474</b>	<b>Domestic</b>
	Të ardhura nga privatizimi		1	1	2	4	10	Privatization receipts
	Hua-marje e brendshme	3,473	4,696	8,647	11,026	15,576	21,436	Domestic new borrowing (net)
	Nacionale	3,482	4,707	8,660	11,048	15,600	21,419	Other
	Lokale	-9	-11	-13	-22	-24	-17	Foreign
	Të tjera	-5,652	-2,952	-8,208	-4,474	-5,116	-4,972	Other
	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	1,838	4,269	771	2,125	3,815	3,145	Government deposits into the Central Bank
	Të tjera	-7,489	-7,219	-8,978	-6,598	-8,932	-8,116	Other
	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-3,545	-3,102	-3,585	-3,093	-4,137	-4,309	Deposits of Social and Health insurance
	Mjete në ruajtje	6	57	23	120	235	318	Preservation stock
	Nën-hua	314	369	552	916	1,029	1,049	On-Loan Principal
	Detyrim ndaj ISSH	-220	-99	-303	712	78	-5	Liabilities to SSI
	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-4,044	-4,444	-6,689	-450	242	110	Other-Float
	<b>I huaj</b>	<b>-632</b>	<b>-749</b>	<b>1,366</b>	<b>617</b>	<b>1,304</b>	<b>5,721</b>	<b>Foreign</b>
	Hua afatgjatë(e marrë)	198	534	3,153	3,996	9,562	8,390	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nën-hua		1,665	1,665	1,642	1,670	2,109	
	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-142	-44	51	185	240	-808	Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-688	-1,385	-1,984	-7,399	-8,498	-10,125	Repayments

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

\*Chang. of stat. Account\* stands for the change in Foreign Financing Deposit

\* Ndryshimi i gjendjes së arkës\* përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

## Tabela e investimeve 2014

Table of investments 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>0</b>	<b>641</b>	<b>1,309</b>	<b>4,025</b>	<b>4,615</b>	<b>7,109</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	0.00	22.75	12.43	35.10	33.60	35.87	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>678</b>	<b>2,177</b>	<b>9,222</b>	<b>7,441</b>	<b>9,119</b>	<b>12,708</b>	<b>Foreign financing</b>
Në %	100.00	77.25	87.57	64.90	66.40	64.13	In %
<b>Totali</b>	<b>678</b>	<b>2,818</b>	<b>10,531</b>	<b>11,466</b>	<b>13,734</b>	<b>19,817</b>	<b>Total</b>
Në %	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2014 (CUSTOMS REVENUES 2014)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	
